


Emri i pacientit:

Datëlindja:



E nderuar paciente! I nderuar pacient!

Kolonografia TK, e quajtur ndryshe edhe kolonoskopi virtuale e zorrës së trashë, është një metodë radiologjike e provuar, e cila mundëson ekzaminimin tërësor të zorrës së trashë në mënyrën më të kujdesshme dhe pa shkaktuar asnjë dëmtim. Ekzaminimi shërben si për të shpjeguar shkaktuesit e shqetësimeve, por edhe si kolonoskopi alternative apo masë profilaktike për parandalimin e kancerit të zorrës së trashë. Ai bazohet në përgatitjen e një tomografie kompjuterike. Të dhënat e grumbulluara përpunohen në imazhe dy dhe tre dimensionale. Pamjet e zorrës së trashë mund të gjenerohen në kompjuter, pa qenë i nevojshëm depërtimi instrumental në zorrë, si gjatë kolonoskopisë së zakonshme. Zakonisht ekzaminimi përballohet shumë mirë nga pacientet dhe pacientët. Marrja e medikamenteve qetësues apo narkozës nuk është e nevojshme.

Si kryhet ekzaminimi?

A duhet të kryej një parapërgatitje e zorrës?

Kolonografia TK bazohet në tre hapa:

1. Dietë dhe pastrim i zorrës përmes laksativës përpara ekzaminimit

Si në të gjitha ekzaminimet e zorrës, mbetjet e ushqimit e kufizojnë vlefshmërinë rezultateve të ekzaminimit, sepse kjo gjë mund të fsheh sëmundje apo të krijoj sëmundje të paqena. Për ekzaminimin e zorrës së trashë, duhet që ajo të jetë e pastruar mirë nga mbetjet ushqimore. Për këtë arsye, një ditë para ekzaminimit, merret një lëndë laksative për ta zbrazur krejtësisht zorrën. Krahas kësaj, në mbrëmjen para ekzaminimit duhet të pini një lëndë kontrasti.

2. Mbushja e zorrës së trashë me CO2 ose ajër

Për të kryer studimin e zorrës së trashë duhet që ajo të jetë pala apo rrudha. Për këtë do të futet me kujdes një tub i hollë, fleksibël, rreth 5-6 cm në rektum. Me anë të këtij tubi zorra do të mbushet plotësisht e me kujdes, me CO2 (dioksid karboni) ose me ajër. Mbushja e zorrës shkakton një ndjesi të lehtë tendosjeje (përafërsisht si "fryrja nga gazrat") në bark, që nga pjesa më e madhe e pacienteve dhe pacientëve vlerësohet si ndjesi e pakëndshme deri dhimbje e lehtë. Për të shmanjur dhimbjet e mundshme në zorrë, përpara mbushjes do t'ju jepet një medikament (buskopan). Gjatë gjithë kohës së ekzaminimit ju do të jeni nën mbikëqyrjen dhe kujdesin e personelit specialist.

3. Ekzaminimi tomografik kompjuterik i abdomenit (barkut)

Tanimë do të kryhet një ekzaminim TK, në shkallë të vogël, i të hapësirës së barkut, duke përfshirë zorrën e trashë të mbushur me ajër, fillimisht në pozicionin shtirë në bark dhe pastaj shtrirë në kurriz, secili regjistrim zgjat 5-15 sekonda. Infuzioni intravenoz i lëndës së kontrastit nuk është i domosdoshëm për vlerësimin e kontrollit të zorrës, por ndonjëherë mund të jetë i rëndësishëm për vlerësimin e organeve të tjera në bark. Ekzaminimi zgjat gjithsej 10-15 minuta. Pas kësaj do të hiqet tubi i hollë nga rektumi dhe ekzaminimi ka përfunduar. Ajri apo CO2 (dioksidi i karbonit) që ndodhet në zorrë do të dalë në rrugë të natyrshme ose do të absorbohet. Pas kontrollit mund të hani e të pini sërish normalisht.

Dobia dhe kufizimet e diagnostikimit të ekzaminimit:


Kolonografia TK është një procedurë e pranuar dhe e njohur në shkallë të gjerë. Ajo përshtatet më së miri veçanërisht për pacientet dhe pacientët, tek të cilët një kolonoskopia e zakonshme nuk është e mundur ose nuk është krejtësisht e mundur. Ajo mund të kryhet edhe si kontroll alternativë për parandalimin e kancerit në zorrën e trashë tek pacientet dhe pacientët, të cilët refuzojnë kolonoskopinë e zakonshme.

Kolonografia TK është e barabartë me koloskopinë e zakonshme për sa i përket gjurmimit të polipeve të rëndësishëm, me diametër 1 cm ose më të mëdhenj, dhe kancerit të zorrës së trashë. Në gjurmimin e polipeve më të vegjël se 6 mm kolonografia TK është inferiore karshi shkallës së zbulimit të kolonoskopisë së zakonshme. Por të tilla gjetje kanë një rëndësi shumë të vogël.

Megjithatë, nëse zbulohet një ndryshim patologjik, ky nuk mund të largohet me anë të kësaj metode. Për këtë është e domosdoshme një kolonoskopi e mëtejshme për heqjen e polipeve apo për marrjen e provës së indit.

Cilat Ponë ndërlikimet që mund të shfaqen?

1. Perforim i zorrës
2. Hemorragji
3. Infeksion



Në raste shumë të rralla, muri zorrës mund të shpohet (perforim i zorrës) ose mund të ndodh hemorragji, si pasojë e mbushjes me ajër apo me CO₂, për shkak të zonave të dëmtuara paraprakisht. Ky rrezik është shumë i rrallë (1 pacient në rreth 3700)¹. Perforimi i zorrës në disa raste mund të çojë në domosdoshmërinë e një operacioni (1 pacient në 12.500) ^[1].

Ekzaminimi TK është i lidhur me ekspozimin ndaj rrezatimit të rrezeve X. Rreziku nga rrezet X të përdorura në ekzaminimin TK është shumë i ulët. Ju jeni rekomanduar të kryeni këtë ekzaminim TK nga mjek-Po/ mjeku juaj, sepse ky ekzaminim është i rëndësishëm për diagnostikimin tuaj. Përparësia mjekësore

është shumë më e madhe se sa rreziku i mundshëm i sëmurjes si pasojë (si pasojë e rrezatimit).

Nëse ju do të merrni një medikament për qetësimin e zorrëve, ai mund të ketë për pasojë përkohësisht tharje të gojës, përsheptim të frekuencës së zëmërës ose çrregullim të aftësisë së përshtatjes së syrit (kufizim të aftësisë së leximit). Në një rast të tillë, ndalohej drejtimi i automjeteve për periudhën kohore prej 45 minutash pas përfundimit të ekzaminimit.

Nëse ju vuani nga glaukoma me kënd të ngushtë ("tensioni i syrit") apo rritja e tensionit të syrit, ju lutemi që përpara ekzaminimit të konsultoheni me mjeken/mjekun tuaj.

Gratë duhet të informojnë gjithmonë mjeken/mjekun e tyre dhe personin e tyre të kontaktit në radiologji (apo radiologjen/radiologun), në rast se ekziston mundësia e të qenit shtatzënë, për arsyen se ky lloj ekzaminimi përgjithësisht, me përjashtim të rasteve emergjente, nuk rekomandohet për gratë shtatzëna.

Pastrimi i zorrës

Vetëm një zorrë e pastër mund të ekzaminohet! Për këtë arsye, parapërgatitja e duhur është absolutisht e domosdoshme. **Për faktin, se për parapërgatitjen ekzistojnë variante të ndryshme, ju lutemi t'i referoheni kërkesave speciale të departamentit që kryen kontrollin!** Në rast se ju merrni ilaçe, ju lutemi të merrni parasysh, që efekti i tyre mund të pezullohet apo kufizohet prej përdorimit të lëndës laksative (heqja e barkut). Kjo vlen p. sh. edhe për "pilulat" ndaj mbrojtjes nga shtatzënia ose për ilaçet që hollojnë gjakun. Andaj, deri në periudhën e ardhshme menstruale, ju rekomandojmë të merrni masa mbrojtëse shtesë ndaj shtatzënisë. Ju lutemi të konsultoheni mbi këtë, si dhe mbi kundër-indikacionet dhe veprimet anësore me mjeken/mjekun tuaj.

Pyetje të rëndësishme para ekzaminimit:

Gjatësia (cm): Pesha (kg):

Anamneza e familjes në lidhje me

Kancer në zorrën e trashë	☐ Jo	☐ Po	
Polipe	☐ Jo	☐ Po	
Sëmundje kronike inflamatore të zorrëve	☐ Jo	☐ Po	
Sëmundje divertikulare	☐ Jo	☐ Po	
Perforim i zorrës	☐ Jo	☐ Po	
Okluzion intestinal	☐ Jo	☐ Po	

Simptomat:

Diarre	☐ Jo	☐ Po	
Temperaturë	☐ Jo	☐ Po	
Kapllëk	☐ Jo	☐ Po	
Hernie/thyerje	☐ Jo	☐ Po	

Ekzaminime të mëparshme të zorrës së trashë?

Cilat/kur?	☐ Jo	☐ Po	
– Plotësisht:	☐ Jo	☐ Po	
– Jo plotësisht:	☐ Jo	☐ Po	
Radiografi zorrësh:	☐ Jo	☐ Po	

Operacione të mëparshme në zonën e barkut, legenit apo në traktin gastrointestinal (stomak-zorrë). Cilat?

(p. sh. operim i apendicitit?)	☐ Jo	☐ Po	
Anus artificial?	☐ Jo	☐ Po	
Radioterapi?	☐ Jo	☐ Po	

Alergji:

Lëndë kontrasti	☐ Jo	☐ Po	
Butylskopolamin/Buskopan	☐ Jo	☐ Po	
Alergji të tjera:	☐ Jo	☐ Po	

Glaukomë

(rritje e presionit intraokular)?	☐ Jo	☐ Po	
-----------------------------------	-----------------------------	-----------------------------	-------

BROSHURË INFORMUESE

Kolonografia TK – kolonoskopia virtuale

Biseda shpjeguese

Me anë të nënshkrimit tim, unë vërtetoj se e kam lexuar dhe kuptuar tekstin e këtij formulari.

Unë u jam përgjigjur pyetjeve sipas dijenive të mia më të mira. Në bisedën personale, më janë shpjeguar rreziqet e mundshme dhe më janë dhënë përgjigje të mjaftueshme për pyetjet e mia të mëtejshme. Unë jam dakord, që ekzaminimi i propozuar të kryhet.

	
Nënshkrimi i pacientes/pacientit dhe/ose i përfaqësuesit ligjor	Nënshkrimi i mjekes/mjekut
Data / ora	Emri dhe nënshkrimi i MTD

Ne ju lutemi që këtë formular t'ia dorëzoni stafit profesional teknik mjekësor që është duke j'u trajtuar, përpara ekzaminimit tuaj.

Shënime mjekësore mbi bisedën shpjeguese	Emri i pacientes/pacientit	
Pacientja/pacienti është dakord për kryerjen e ekzaminimit	Po ☐	Jo ☐

Në rastin e refuzimit të ekzaminimit, pacientja/pacienti është informuar mbi disavantazhet e mundshme që rrjedhin prej tij.